

# Rezultatet Rajonale të Statistikave Strukture të Ndërmarrjeve, 2016

**Tiranë, më 30 prill 2018:** Statistikat strukture të ndërmarrjeve sipas rajoneve kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike sipas rajoneve . Të dhënat rajonale janë vlerësuar duke u bazuar në një model, i cili ndërthur të dhënat e Regjistrit të Njësive Lokale, së bashku me të dhënat për Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve, për shpërndarjen e tyre sipas rajoneve. Modeli i ndërtuar bazohet në produktivitetin e punonjësve të njësive lokale sipas aktivitetit ekonomik. Për këtë arsye, treguesit rajonalë janë vlerësuar vetëm për variablat e lidhur me numrin e të punësuarve.

Në vitin 2016, bazuar në rezultatet finale të Statistikave Strukturore pranë Ndërmarrjeve që operojnë në aktivitetet prodhuese të të mirave dhe shërbimeve, vlera e shtuar është 491.026 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 6,7 %, krahasuar me vitin 2015.


Më poshtë paraqitet struktura e treguesve dhe kontributi në ndryshimin vjetor sipas rajoneve statistikore për vitin 2016. Nga rezultatet vërehet se peshën më të madhe në vend, në të gjithë treguesit e njësive lokale, e ka rajoni Qendër, i cili përbën 40,8 % të numrit të njësive lokale, 50,9 % të të punësuarve dhe 59,5 % të vlerës së shtuar. Ky rajon ka kontributin më të madh në ndryshimin vjetor të vlerës së shtuar prej 6,4 pikë përqindje, pasuar nga rajoni Veri me 1,5 pikë përqindje dhe rajoni Jug, i cili gjatë vitit 2016 ka dhënë një kontribut negativ me -1,2 pikë përqindje.

**Tab. 1 Struktura e treguesve dhe kontributi në ndryshimin vjetor sipas rajoneve statistikore, 2016**

Kodi	Niveli Statistikor 1/2	Struktura %			Kontributi në ndryshimin vjetor		
		Njësité lokale	Të punësuarit	Vlera e Shtuar	Njësité lokale	Të punësuarit	Vlera e Shtuar
AL	Shqipëri	100	100	100	4,9	7,9	6,7
AL01	Veri	26,4	25,0	20,2	2,7	2,5	1,5
AL02	Qendër	40,8	50,9	59,5	-0,3	3,0	6,4
AL03	Jug	32,7	24,1	20,3	2,5	2,4	-1,2

Kontributin më të madh në rritjen e vlerës së shtuar për vitin 2016 e ka dhënë qarku Tiranë me + 6,1 pikë përqindje, pasuar nga qarku Durrës dhe Vlorë me + 0,9 pikë përqindje secili. Qarku Fier ka kontribuar negativisht në treguesin e vlerës së shtuar me -3,2 pikë përqindje, duke u influencuar nga sektori i industrisë nxjerrëse, si aktiviteti kryesor në këtë qark.

**Fig.1 Kontributi në përqindje i vlerës së shtuar sipas qarqeve, 2016**



Më poshtë paraqitet struktura e vlerës së shtuar sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike për vitin 2016. Nga rezultatet vërehet se qarku i Tiranës dhe Durrësit kanë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar, pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike.

Në aktivitetin e industrisë nxjerrëse, qarku Fier ka peshën më të madhe të vlerës së shtuar me 57,4 %, pasuar nga qarku Dibër me 22,0 %.

Në aktivitetin e energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve, qarku Tiranë dhe Fier kanë peshën më të madhe të vlerës së shtuar, përkatësisht me 37,4 % dhe 11,2 %.

**Tab. 2 Struktura e vlerës së shtuar (%) sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike, 2016**

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	Gjithsej	Aktivitetet Ekonomike							
			Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	En. elek., gaz, uji & trajtimi i mbetjeve	Ndërtimi	Tregtia	Akomodimi & shërbimi ushqimor	Transp., inform. & komunikacioni	Shërbimet
<b>AL</b>	<b>Shqipëri</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>20,2</b>	<b>27,4</b>	<b>31,3</b>	<b>26,1</b>	<b>14,3</b>	<b>19,9</b>	<b>21,1</b>	<b>14,2</b>	<b>14,1</b>
AL011	Dibër	2,8	22,0	3,3	5,8	1,0	0,9	0,6	0,6	0,7
AL012	Durrës	10,4	2,3	19,9	3,8	5,8	12,5	10,1	10,8	9,8
AL013	Kukës	1,2	0,5	0,3	6,8	0,8	0,5	1,0	0,5	0,5
AL014	Lezhë	2,1	2,3	2,8	2,5	2,9	2,4	3,5	1,3	0,8
AL015	Shkodër	3,6	0,3	5,0	7,1	3,8	3,6	5,8	1,1	2,3
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>59,5</b>	<b>12,4</b>	<b>47,9</b>	<b>44,6</b>	<b>70,2</b>	<b>57,6</b>	<b>52,7</b>	<b>77,1</b>	<b>75,7</b>
AL021	Elbasan	4,3	2,2	8,8	7,2	2,9	4,1	5,1	1,8	2,3
AL022	Tiranë	55,2	10,2	39,0	37,4	67,3	53,5	47,6	75,3	73,4
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>20,3</b>	<b>60,2</b>	<b>20,9</b>	<b>29,3</b>	<b>15,5</b>	<b>22,6</b>	<b>26,2</b>	<b>8,7</b>	<b>10,2</b>
AL031	Berat	2,3	2,4	4,1	2,1	3,3	2,1	2,4	1,0	1,1
AL032	Fier	8,1	57,4	4,1	11,2	4,8	7,1	5,6	2,2	3,4
AL033	Gjirokastrë	2,1	0,0	3,9	2,6	1,3	3,3	2,4	0,9	0,9
AL034	Korçë	3,4	1,0	4,7	4,7	2,2	4,3	7,3	2,0	1,9
AL035	Vlorë	4,5	-0,7	3,9	8,7	3,9	5,8	8,7	2,6	2,9

Në vitin 2016, numri i njësive lokale të rezultuara aktive shënoi një rritje pothuajse në të gjitha qarqet, krahasuar me vitin 2015.

Në tabelën 3, paraqitet struktura e numrit të njësive lokale, sipas rajoneve dhe aktiviteteve ekonomike, për vitin 2016.

Nga rezultatet vërehet se qarku i Tiranës ka numrin më të lartë të njësive lokale, pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike, duke përbërë 32,1 % të njësive lokale në vend, edhe pse ky tregues shënoi një rënie prej 4,5 %, krahasuar me vitin e kaluar. Qarku Kukës ka peshën më të ulët të numrit të njësive lokale në vend me 1,5 %.

Në aktivitetin e industrisë nxjerrëse, qarku Dibër ka peshën më të madhe të numrit të njësive lokale me 23,4 %, mbizotëruar nga industria e kromit, ndërsa qarku Gjirokastrë ka përqindjen më të ulët të numrit të njësive lokale me 0,3 %.

**Tab. 3 Struktura e numrit të njësive lokale sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike, 2016**

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	Gjithsej	Aktivitetet Ekonomike							
			Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	En. elek., gazi, uji & trajtimi i mbetjeve	Ndërtimi	Tregtia	Akomodimi & shërbimi ushqimor	Transp., inform. & komunikacioni	Shërbimet
<b>AL</b>	<b>Shqipëri</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>26,4</b>	<b>42,3</b>	<b>27,1</b>	<b>27,2</b>	<b>24,3</b>	<b>28,1</b>	<b>27,4</b>	<b>23,4</b>	<b>23,3</b>
AL011	Dibër	2,3	23,4	2,2	2,7	2,9	2,1	2,5	2,7	1,7
AL012	Durrës	11,6	5,5	14,0	8,6	12,6	12,6	10,1	9,0	11,0
AL013	Kukës	1,5	2,9	0,6	2,1	1,8	1,6	1,7	1,8	1,2
AL014	Lezhë	4,5	6,6	4,0	6,2	4,0	5,0	4,9	4,7	3,3
AL015	Shkodër	6,6	3,9	6,2	7,7	3,0	6,7	8,3	5,1	6,1
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>40,8</b>	<b>29,9</b>	<b>37,1</b>	<b>30,8</b>	<b>42,2</b>	<b>37,6</b>	<b>37,8</b>	<b>42,6</b>	<b>50,6</b>
AL021	Elbasan	8,7	8,8	9,2	8,2	2,4	9,3	10,1	10,1	6,8
AL022	Tiranë	32,1	21,1	27,9	22,5	39,7	28,3	27,8	32,5	43,8
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>32,7</b>	<b>27,8</b>	<b>35,9</b>	<b>42,1</b>	<b>33,5</b>	<b>34,3</b>	<b>34,8</b>	<b>34,1</b>	<b>26,1</b>
AL031	Berat	4,5	7,6	5,3	8,2	2,2	5,0	3,9	5,8	3,5
AL032	Fier	10,2	11,0	11,7	15,8	9,6	11,6	9,8	8,8	7,8
AL033	Gjirokastrë	2,9	0,3	3,0	1,4	2,2	3,2	3,1	3,1	2,3
AL034	Korçë	6,5	4,8	7,7	9,2	6,5	6,2	7,1	8,8	5,5
AL035	Vlorë	8,5	4,0	8,2	7,4	13,0	8,3	10,9	7,5	6,9

Numri i të punësuarve në njësitë lokale të rezultuara aktive gjatë vitit 2016 është 469.665, duke shënuar një rritje prej 7,9 %, krahasuar me vitin 2015.

Qarku Kukës ka numrin më të ulët të të punësuarve në vend me 1,4 %, megjithëse gjatë vitit 2016 ky tregues shënoi përqindjen më të lartë të rritjes së punësimit me 26,0 %, krahasuar me vitin 2015.

Edhe për treguesin e punësimit, Tirana është qarku me përqindjen më të lartë të të punësuarve, pothuajse në të gjitha aktivitetet ekonomike. Ndryshim bën industria nxjerrëse, ku punonjësit në këtë aktivitet janë të përqendruar kryesisht në qarkun Dibër (29,2 %) dhe Fier (26,5 %). Durrësi është qarku i dytë, pas Tiranës, që zë përqindjen më të lartë të punësimit në industrinë përpunuese (20,5 %), ndërtim (9,4 %) dhe aktivitet prodhuese të shërbimeve (10,2 %). Në aktivitetet e energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve, peshën më të madhe të numrit të punonjësve, pas qarkut Tiranë (29,2 %), e ka qarku Fier (11,7 %).

**Tab. 4 Struktura e numrit të të punësuarve sipas rajoneve statistikore dhe aktiviteteve ekonomike, 2016**

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	Gjithsej	Aktivitetet Ekonomike							
			Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	En. elek., gaz, uji & trajtimi i mbetjeve	Ndërtimi	Tregtia	Akomodimi & shërbimi ushqimor	Transp., inform. & komunikacioni	Shërbimet
<b>AL</b>	<b>Shqipëri</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	25,0	42,3	32,9	24,5	22,5	24,3	26,0	22,7	18,3
AL011	Dibër	2,1	29,2	1,4	4,1	1,7	1,3	1,6	1,3	1,1
AL012	Durrës	12,7	3,9	20,5	7,8	9,4	11,9	10,8	13,2	10,2
AL013	Kukës	1,4	1,9	0,3	3,4	2,0	1,7	2,4	1,5	0,7
AL014	Lezhë	3,5	2,4	3,9	3,9	4,7	4,0	4,8	3,1	1,7
AL015	Shkodër	5,4	4,9	6,8	5,2	4,7	5,4	6,4	3,6	4,6
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	50,9	16,0	42,7	38,3	52,8	47,9	48,3	57,5	65,5
AL021	Elbasan	5,8	3,8	4,9	9,1	5,2	7,1	7,7	5,3	4,2
AL022	Tiranë	45,1	12,2	37,8	29,2	47,6	40,8	40,5	52,2	61,3
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	24,1	41,7	24,4	37,1	24,7	27,8	25,7	19,8	16,2
AL031	Berat	3,5	7,4	5,5	4,8	3,5	3,7	2,3	3,0	1,7
AL032	Fier	7,4	26,5	5,6	11,7	8,3	9,1	6,2	5,3	5,5
AL033	Gjirokastrë	2,5	0,2	3,0	4,6	2,6	3,3	2,2	2,3	1,4
AL034	Korçë	4,7	2,0	5,4	7,7	4,3	5,0	6,0	4,9	2,9
AL035	Vlorë	5,9	5,5	4,8	8,4	6,0	6,7	9,1	4,3	4,6

# Metodologjia

Ky publikim paraqet rezultatet mbi Statistikat strukturore të ndërmarrjeve, sipas rajoneve, të cilat kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën sipas rajoneve dhe aktiviteteve ekonomike. Rajonet statistikore, në nivel 1, 2 dhe 3, janë të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, i cili është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen statistikat rajonale evropiane.

Të dhënat rajonale janë vlerësuar duke u bazuar në një model në të cilin përdoret struktura e variablave ndërmjet aktiviteteve të ndryshme, për të përcaktuar nivelin në të cilin çdo variabël duhet të kontribuojë në njësinë lokale, në varësi të aktivitetit të kësaj njësie. Për të realizuar këtë model përdoret Regjistri i Njësive Lokale, së bashku me të dhënat për ndërmarrjet, që merren nga Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve. Informacioni i përdorur nga njësitë lokale janë aktiviteti dhe numri i punonjësve në këto njësi.

Supozimi kryesor është se variablat e statistikave strukturore janë të lidhura me punësimin, por mund të ketë diferenca mes aktiviteteve të ndryshme. Disa aktivitete kanë diferenca të ndryshme ndërmjet punësimit dhe variablave të tjerë, si për shembull, nëse përdorin më shumë kapital, pra janë kapital-intensiv dhe përdorin më pak forcën punëtore. Çdo raport variabël / punësim, në këtë rast, do të ishte më i lartë.

Informacion më të detajuar rreth Statistikave Strukturore dhe Regjistrin të Njësive Lokale mund ta gjeni në linqet më poshtë:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/statistikat-strukturore-të-ndërmarrjeve-ekonomike/#tab4>

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-shërbimet/regjistri-statistikor-i-ndërmarrjeve/#tab4>

## Përkufizime të variablave

**Ndërmarrja** është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë ligjore me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendimmarrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrorë një ose disa aktivitete ekonomike.

## Njësia lokale

Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj (p.sh manufakturë, fabrikë, magazinë, zyrë, minierë apo depo) të ndodhura në zona të identifikuar gjeografikisht. Tek ky apo nga ky vend ushtrorë aktiviteti ekonomik për të cilin – me përjashtim të disa rasteve - punojnë një ose më shumë persona (edhe pse me kohë të reduktuar) për një ndërmarrje të vetme. Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2.

Organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë përfshin tri rajone bazuar në 12 qarqe:

Rajoni I: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër;

Rajoni II: Elbasan, Tiranë;

Rajoni III: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë.

**Numri i të punësuarve** përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje, përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

**Prodhimi** është një aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale (ndërmarrje) që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalit dhe lëndës së parë për të prodhuar të mira dhe kryer shërbime.

**Vlera e prodhimit** bazohet në:

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve (shitjet neto) të krijuara nga vetë ndërmarrja:

(±) Ndryshimet e gjendjes së produkteve të gatshme dhe në proces

(±) Ndryshimet në gjendjen e mallrave dhe shërbimeve të blera për rishitje në të njëjtat kushte

(-) Blerjet e mallrave dhe shërbimeve për rishitje në të njëjtat kushte

(+) Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndërmarrja për llogari të vet

(+) Subvencionet.

**Konsumi ndërmjetës** përfaqëson vlerën e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk përfshihet në vlerën e konsumit ndërmjetës.

**Vlera e shtuar** me çmime bazë llogaritet si diferencë e vlerës së prodhimit me konsumin ndërmjetës.